



3/6
2.3.26 KBL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

VENDIM

Nr. 1, datë 19.02.2026

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT
NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “ALBAN SHABA” P.F, ME
VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE RASHBULL, FSHATI
SHËNAVLASH, BASHKIA DURRËS.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime të ndryshme, të subjektit “Alban Shaba” P.F, me vendndodhje: Njësia Administrative Rashbull, Fshati Shënavlash, Bashkia Durrës.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor (pus-shpimi):

- X= 456762.191
- Y= 4580516.010
- Z= 25 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.1$ l/sek
- Qëllimi i përdorimit të ujit: Për larje automjetesh.
- Thellësia e pus-shpimit: 12 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 11 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

$X = 456748.907;$

$Y = 4580530.200;$

$Z = 24.5$ m

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.1$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ERZEN

SHKËLQIM HAJDARI

